

I.B.C-Telecom Sh.p.k

Shenime mbi pasqyrat financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacion i Pergjithshem

Themelimi I Subjektit:

I.B.C-Telecom shpk eshte themeluar me date 24/05/2010 dhe regjistruar ne QKB me date 01/06/2010 me CN-401448-06-10. Nipti: L06801002A

Funksionimi i kesaj shoqerise eshte bazuar ne ligjin Nr7638 Dt.19.11.1992 « Per Shoqerite Tregtare » dhe ligjit Nr.7667, Dt. 28.01.1993 « Per Rregjistrin Tregtar

Kapitali dhe pronësia

I.B.C-Telecom Sh.p.k ne mbyllje te vitit 2021 ka një kapital të regjistruar prej 12.100.000, lekë , dhe zoterohet nga ortaku I vetem Z. Gjergj Ejlli qw zotwron 100% te kuotave.

a) **Administrimi dhe drejtimi**

Drejtimi i pershtaten natyres se Shoqerise dhe realizimit te objektit të veprimtarisë së saj. Administrator i Shoqerise eshte z Gjergj Ejlli.

b) **Adresa e shoqerise**

Shkoder, Rruga Marin Biçikemi,Perballe Katedrales, godina 4-kateshe, kati i pare, nr 9

Adresa dytwsorw ;

- Shkoder Kastrat BAJZE Bajze, qender ngjitur me pallatet
- Lezhe Lagjja Varosh, Bulevardi At GjergjFishta, Nr Pasurie 4/58-N31, Zona kadastrale 8632, kati I-re,
- Shkoder , Lagjja Partizani, RrugaEuropa, nr 788
- Shkoder Lagjja Qemal Stafa, Bulevardi Zogu i Pare, nr pasurie 2/108-N18, zona kadastrale 8591
- Shkoder, Koplik,perballe Ujesjelles Kanalizimeve

c) **Objekti i veprimtarise**

Sherbime telekomunikacioni. Ndertim dhe shfrytezim te rrjeteve te telekomunikacionit. Sherbime audiovizive

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit te Permiresuara. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te konstatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2021 eshte zbatuar formati i SKK-2 te ndryshuar.

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej të tremeve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 30.09.2020 janë 1 euro = 120.76 dhe 1 dollar = 106.54 leke.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin perfaqson shumën e tatimit për të paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2021 është 15 % i pandryshuar nga ushtrimi i mëparshëm.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabel e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabel e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e vlerës se mbetur të aktiveve të qëndrueshme.

Normat e perdorura jane ne ndertesa 5 % , dhe per aktivet e tjera 20% dhe 25% per paisjet informatike .

Gjendjet e inventaret

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

1. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2021 jane si me poshte:

Kodi	Përshkrimi	Nr. Llogarie	Monedha	Gjendja ne MB
ABALL	Alpha Bank ALL	5121	LEK	3,574.00
BKTALL	Banka Kombetare Tregtare ALL	5121	LEK	278.02
BKTEUR	Banka Kombetare Tregtare EURO	512402	EUR	4,250.75
OTP.ALL	OTP Bank ne ALL	5124	LEK	10,043.32
OTP.EUR	OTP Bank ne Euro	512402	EUR	440.77
PCREURO	ProCredit Bank ne EURO	512402	EUR	2,691,376.91
PRCUSD	ProCredit Bank USD	512401	USD	2,088.18
RBEURO	Raiffeisen Bank EURO	512402	EUR	533.76
RBUSD	Raiffeisen Bank USD	512401	USD	50.66
	Totali i Bankave:			2,712,636.38

.....
Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.

2. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2021 deklarohen si vijon:

Aktive te tjera afatshkurtra financiare				
Llogari/Kerkesa te arketueshme			4,504,104.18	5,222,583.09
Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme			4,707,473.00	12,638,928.21
Instrumente te tjera borxhi			0.00	0.00
Investime te tjera financiare			0.00	0.00
Shuma	I.3		9,211,577.18	17,861,511.30

.....
Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar faturat e papaguara per shitjet qe shoqeria ka realizuar per vitin ushtrimor 2021

Kerkesa te tjera e arketueshme 4,707,473 leke : Teprice kreditore e TVSH se.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

3. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

Shuma	I.3		9,211,577.18	17,861,511.30
Inventari				
Lendet e para			22,291,062.86	4,766,795.63
Parapagesat per furnizime			20,000.00	20,000.00
Shuma	I.4		22,311,062.86	4,786,795.63

.....

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2021. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e koston se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes koston se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

4. Aktivet Afatgjata Materiale(Financiare)

.....

5. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2021						
Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2021	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2021
1	Toka		0	0	0	0
2	Ndertime		0	15,600,102	196,604	15,403,498
3	Linja Transmetimi		161,468,119	1,614,790	8,073,406	155,009,503
4	Makineri,paisje		27,133,041	22,428,470	7,103,118	42,458,393
5	Mjete transporti		2,581,996	7,140,444	1,832,569	7,889,871
6	kompjuterike		1,733,540	3,740,411	1,426,695	4,047,256
1	Zyre		217,452	9,583	41,682	185,353
2	Te tjera		256,833	195,117	15,821	436,129
3			0	0	0	0
	TOTALI		193,390,981	50,728,917	18,689,894	225,430,004

.....

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve kontabel qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2021. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston.Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

6. Detyrime afatshkurtera- Huate dhe parapagimet

Detyrime afatshkurtra		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	3,720,401	
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	76,282,745	59,186,601
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	6,182,190	5,709,651
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	1,152,311	1,541,919
<i>Te tjera te pagueshme</i>	0	8,420,991
Totali i detyrimeve afatshkurtra	87,337,647	74,859,162

.....

Shuma 3,720,401 leke eshte Owerdraft tek Raifaizen Bank.

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave pa u likjuar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejta e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

Te pagueshme per detyrimet tatimore jane T fitimi, sigurimet , Tap dhe Tatimi ne burim per muajin dhjetor 2021.

7. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2021 paraqiten si vijon:

Detyrime afatgjata		
<i>Titujt e huamarrjes</i>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	57,651,940	39,348,970
<i>Hua te tjera</i>	35,855,965	35,855,965
<i>Te tjera te pagueshme</i>	41,337,460	23,166,406
Totali i detyrimeve afatgjata	134,845,365	98,371,341

Shuma 57,651,940 leke kredi bankare tek ProCredit Bank, Shuma 35,855,965 kredi nga personat private

Shuma 41,337,460 jen investime ne biznes nga ortkai i shoqerise.

.....

Jane kredi bankare nga ProCredit Bank.

8. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2021 ai eshte 12.100.000 leke, i ndare ne nje kuote dhe zoterohet plotessht nga ortaku i vetem Gjergj Ejlli.

9. Fitimi (humbja) e vitit financiar

10. Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor (interneti)</i>	126,212,081	138,356,342
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor I (Televizion)</i>	44,344,785	
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor (Shitje prod I gatshem)</i>	3,500,000	
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor (Shitje te tjera)</i>	164,240	

.....

Të ardhurat nga shitja e sherbimeve e mallrave jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e

ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja. Te ardhurat nga shitja e mallrave perfaqesojne shitjen e mallrave dhe materialeve te para.

11. Shpenzimet e veprimtarise kryesore

<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	(61,222,173)	(158,883,839)
<i>Te tjera shpenzime</i>	(19,373,483)	0

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2021 jane treguar ne pasqyren perkatese.

12. Shpenzimet e tjera te shfytzimit

613	Qira	(516,600.00)
628	Shpenzime per sherbimet bankare	(911,010.73)
634	Taksa dhe tarifa vendore	(1,146,608.00)
657	Gjoba dhe demshperblime	(161,899.21)
658	Shpenzime te tjera korente	(4,225,924.76)
	Totali	-6,962,043

Jane shpenzime jo me fature , por pagesa te ndryshme sipas zerave perkates ne tabelen e mesiperme.

13. Shpenzimet dhe te ardhurat financiare

interesa	(2,725,913.44)
fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit	2,285,000.95
te tjera financiare	106,920.00
Totali (a+d)	(333,992.49)
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	(333,992.49)

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

14. Shpenzime personeli

Shpenzime te personelit		
<i>Paga dhe shperblime</i>	(35,575,488)	(19,595,002)
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	(5,671,264)	(3,282,952)

Analiza e shpenzimeve bauer ne librin i blierieve:

	Shuma e blerjeve te raportuara me FDP	180,578,901
	Nga kjo Zbriten	
1	Aktiva Afat Gjata Materiale (-)	-50,857,909
3	Referenca per importe mallrash (-)	-39,333
	Referenca per importe investime (-)	0
4	Shpenzime per periudhat e ardheshme (-)	0
5	Parapagime per aktive afatgjata ne proces	-31,567,352
6	Te tjera ...shpenzime te panjohura(transporte pa fature)	0
	Shuma e shpenzimeve te raportuara ne FDP	98,114,307
	Gjendja e inventarit ne celje	4,786,796
	Parapagime per inventar	0
	Gjendja e inventarit n e fund te vitit	22,311,063
I	Kosto e blerjeve	80,590,040

15. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2021 jane si vijon:

14	Fitimi (Humbja) para tatimit	26,398,895.34
	Shpenzime te panjohura	161,899
	Fitimi mbi te cilin llogaritet tatimi	26,560,794
+ 15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-3,984,119
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	22,414,776

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

16. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , veç huase se marre nga ortakun nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

17. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2021 dhe 2020 jane ndertuar sipas SKK-ve dhe jane plotesishte te krahasueshme

Hartuesi I P. Financiare

[Signature]

Administratori

